

VENDIM
Nr. 186, datë 25.3.2021

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 568, DATË 17.7.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË
FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 59, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 5.4, të kreut III, të vendimit nr. 568, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 5.4/1, 5.4/2 dhe 5.4/3, me këtë përmbajtje:

“5.4/1 Në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit krijohet Komisioni i Ankimit të AKM-së, i cili drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm dhe ka në përbërje të tij:

- a) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për inspektimin dhe kontrollin;
- b) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për shërbimet mbështetëse;
- c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për ankimet;
- ç) nëpunësin përgjegjës për çështjet juridike/ligjore të agjencisë.

5.4/2 Në mungesë të anëtarëve të Komisionit të përcaktuar në pikën 5.4/1, për shkak të mosplotësimit të pozicionit të punës, drejtori i Përgjithshëm cakton zëvendësuesin e njësisë përgjegjëse respektive, deri në plotësimin e vendit vakant.

5.4/3 Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Ankimit të AKM-së përcaktohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe